



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 26.09.2012
Nr. 0204/2001

PËR: Naim Ismaili, Kryetar i Komunës së Shtimes
Kujtim Xhelili, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes

LËNDA: KËRKESË PËR RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË VENDIMEVE TË KOMUNËS SË SHTIMES, të pranuar me datë; 21.09.2012.

Të nderuar

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të hollësishëm të ligjshmërisë së Vendimeve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Shtimes me datë 23.08.2012, **KONSTATON** se;

Janë në kundërshtim me nenin 5 dhe 7 të Ligjit nr. 03/L-226 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 2012/02 për Zbatimin e Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Vendimet e listuara për të cilat kërkohet rishqyrtim, janë si vijon;

- Vendimi për Dhënien e Pëlqimit në Kërkesën 01 Nr.07/1646-2 për z. Muhamed Himay-Firma "Dragon Çelik" - Prishtinë,
- Vendimi për Dhënien në Shfrytëzim 26.47 ari Sipërfaqe z. Muhamed Himay-Firma "Dragon Çelik" - Prishtinë, për Vendorsje të Pajisjeve për Gurthyes,
- Vendimi për Dhënien e Pëlqimit në Kërkesën.01 Nr. 07/1572 të Hajri Xhelilit, Firma NPSH "Shpejtimi"-Shtime,
- Vendim për e një Trualli për Familjen e Dëshmorit Ali Tafa nga Fshati Carralevë,
- Vendimi për Ndarjen e 10 Trojeve për Invalidët e Luftës së UÇK-së Dega në Shtime,

Prandaj, MAPL kërkon nga Kryetari i Komunës së Shtimes dhe Kryesuesi i Kuvendit, të ndërmarrin veprime konkrete që Vendimet e lartcekura të harmonizohen me dispozitat përkatëse ligjore në fuqi, duke respektuar të gjitha parimet dhe procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, brenda 30 ditësh nga data e pranimi të kërkesës për rishqyrtim të akteve në fjalë.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,



Kopje: *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së*
Drejtoreve të Departamenteve
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum, 26.09.2012
Br. 0204/2001

Za: Naim Ismaili, Gradonačelnik opštine Štimlje
Kujtim Xhelili, Predsedavajući skupštine opštine

Predmet: ZAHTEV O PONOVNOM RAZMATRANJU ZAKONITOSTI ODLUKA
OPŠTINE ŠTIMLJE primljen dana ; 21.09.2012.

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom definisano zakonom Br. 03/Z-040 o Lokalnoj samoupravi, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i ministarstva, nakon detaljnijeg razmatranja zakonitosti odluka odobrenih od strane skupštine opštine Štimlje dana 23.08.2012, **KONSTATUJE** da;


Ove odluke su u suprotnosti sa članom 5 i 7 zakona br. 03/Z-226 o davanju na koristi i razmenu nepokretnog opštinskog zemljišta kao i administrativnog uputstva Br. 2012/02 o sprovođenju zakona o davanju na koristi i razmenu nepokretne opštinske imovine..

Odluke koje moraju ponovo biti razmatrane su kao što slede;

- Odluka o davanju saglasnosti na zahtev 01 Br.07/1646-2 za g. Muhamed Himay-Firma "Dragon Čelik" - Priština,
- Odluka o davanju na koristi 26.47 ari površine g. Muhamed Himay-Firma "Dragon Čelik" - Priština, o postavljanju opreme za kamenolomlje,
- Odluka o davanju saglasnosti na zahtev .01 Br. 07/1572 g. Hajri Xhelilit, Firma NPSH "Špejtimi"-Štimlje
- Odluka o dodeljivanju parcele porodici poalog borca Ali Tafa sela Caralevo,
- Odluka o dodeljivanju 10 parcela za invalide rata OVK -Štimlje,

Tako da MALS -a zahteva od strane Gradonačelnika opštine Štimlje kao i od strane predsedavajućeg opštine da preduzmu konkretne mere stim da bi gore navedene odluke bile usklađene prema dotičnim odredbama na snazi, poštujući sve principe i procedure o davanju na koristi i razmenu nepokretne opštinske imovine, u roku od 30 dana od dana prijema zahteva o ponovnom razmatranju gore navedenih akata. .


Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i ministar MALS-a,



Kopija: *Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a*
Direktorima odeljenja
Arhivi MALS-a



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr. 06/1695, Datë: 23.8.2012



Npi – 01/197, Datë: 6.9.2012

Kuvendi Komunal – Shtime, shqyrtoi kërkesën me numër. 01Nr.07/1646-2, datë: 16.8.2012, të paraqitur nga z.Muhamed Himay, përfaqësues i firmës “Dragon Çelik” sh.p.k Adresa: rr. “Agim Ramadani”, Aktashi C. H-3/2, Floor 1, Nr.2, 10000-Prishtinë, i cili ka kërkuar nga Kuvendi Komunal-Shtime, dhënien e Pëlqimit për vendosjen e makinerisë për përpunimin e Gurit, në pjesën e Ngatrës Kadastral, Nr: 22, Zona Kadastrale -Petrovë, sasia: 01.73.53. (një hektar e shtatëdhjetë e tre ari e pesëdhjetë e tri metra) sipërfaqe. Prona evidentohet, Pasuri Shoqërore e Pyjeve - Shtime. Kuvendi Komunal pasi analizoi, kërkesën e palës, dhe rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, mori këtë:

V E N D I M

PËR DHËNJEN E PËLQIMIT NË KËRKESËN 01Nr.07/1646-2
PËR z.MUHAMED HIMAY – FIRMA “DRAGON ÇELIK” – PRISHTINË,

I


Kuvendi Komunal-Shtime, në mbledhjen e tetë të rregullt për vitin 2012, të mbajtur më: 6.9.2012, me shumicën e votave ka vendosur që ta aprovoi kërkesën 01Nr.07/1646-2 të datës:16.8.2012, të z.Muhamed Himay nga Prishtina, përfaqësues i firmës (“Dragon Çelik”) për dhënien e Pëlqimit për vendosjen e makinerisë për përpunimin e Gurit, në pjesën e Ngatrës Kadastral, Nr: 22, Zona Kadastrale -Petrovë, sasia; 01.73.53. (një hektar e shtatëdhjetë e tre ari e pesëdhjetë e tri metra) Prona evidentohet, Pasuri Shoqërore e Pyjeve - Shtime.

II

Pëlqimi palës i lëshohet për kompletimin e dokumentacionit për leje të punës, që duhet ta sigurojë nga Ministria për Planifikim Hapësinor, përkatësisht nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. Pala është e obliguar që brenda 6 (gjashtë) muajve të fillojë aktivitetet për përpunimin e gurit, në këtë lokacion në të kundërtën ky vendim anulohet.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesi Kuvendit
Kujtim Xhelili



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr. 06/1695, Datë: 23.8.2012



Npi – 01/196, Datë: 6.9.2012

Kuvendi Komunal – Shtime, shqyrtoi kërkesën me numër, 01Nr.07/1646-1, datë: 16.8.2012, të paraqitur nga z.Muhamed Himay, përfaqësues i firmës “Dragon Çelik” sh.p.k Adresa: rr. “Agim Ramadani”, Aktashi C, H-3/2, Floor 1, Nr.2, 10000-Prishtinë, i cili ka kërkuar nga Kuvendi Komunal-Shtime, dhënie në shfrytëzim, pjesën e Ngastres Kadastrale Nr.402, Zona Kadastrale - Topillë, sasia; 00.26.47 (njëzet e gjashtë ari e katërdhjetë e shtatë metra) e cila i nevojitet për vendosjen e makinerisë për thërmimin e gurit natyror. Prona evidentohet, Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime. Plani ynë është që të punësojmë rreth 40 punëtorë të profileve të ndryshme nga Komuna e Shtimes. Pajisjet janë të teknologjisë me standarde të larta. Kuvendi Komunal pasi analizoi, kërkesën e palës, dhe rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, mori këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM 26.47 ARI SIPËRFAQE Z.MUHAMED HIMAY – FIRMA
“DRAGON ÇELIK” – PRISHTINË, PËR VENDOSJE TË PAISJEVE PËR GURTHYES

I


Kuvendi Komunal-Shtime, në mbledhjen e tetë të rregullt për vitin 2012, të mbajtur më: 6.9.2012, me shumicën e votave ka aprovuar kërkesën 01Nr.07/1646-1 të datës:16.8.2012, të z.Muhamed Himay nga Prishtina, përfaqësues i firmës (“Dragon Çelik”) për dhënie në shfrytëzim, pjesën e Ngastres Kadastrale Nr.402, sasia; 00.26.47 (njëzet e gjashtë ari e katërdhjetë e shtatë metra) e cila i nevojitet për vendosjen e makinerisë për thërmimin e gurit natyror. ZK –Topillë, Prona evidentohet, Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime.

II

Vendimi palës i lëshohet për kompletimin e dokumentacionit për leje të punës, që duhet ta sigurojë nga Ministria për Planifikim Hapësinor, përkatësisht nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. Pala është e obliguar që brenda 6 (gjashtë) muajve të fillojë aktivitetet për përpunimin e gurit, në këtë lokacion në të kundërtën ky vendim anulohet.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesi Kuvendit
Kujtim Xhelili



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr. 06/1695, Datë: 23.8.2012



Npi – 01/195, Datë: 6.9.2012

Kuvendi Komunal – Shtime, shqyrtoi kërkesën me numër 01Nr.07/1572, datë: 7.8.2012, të z.Hajri Xhelili, (firma NPSH "Shpejtimi" sh.p.k) Rr."12 Qershori" – Shtime, i cili ka kërkuar nga Kuvendi Komunal-Shtime, dhënien e Pëlqimit për shfrytëzimin dhe përpunimin e Gurit natyror me qëllim të zgjerimit të biznesit, në ngastrën kadastrale Nr.800-0 në vendin e quajtur "Lugu i Shtogut" kultura mal i kl. të -V- me sipërfaqe gjithsej 03.00.00. (tre hektar) evidentuar në fletën poseduese me Nr.00120, Z.K.-Belinc, Pasuri Shoqërore e Ekonomisë Pyjore. Kjo sipërfaqe më nevojitet për arsye se tani është rritë kapaciteti i prodhimit dhe gjithashtu është shtuar edhe numri i punëtorëve. Bëj me dije se para 5 vitesh i njëjti organ më ka dhënë Pëlqimin, afër të njëjtit lokacion, për shfrytëzimin e gurit natyror në sipërfaqe prej 2 hektarëve.

Kuvendi Komunal pasi analizoi, kërkesën e palës, dhe rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, mori këtë:

V E N D I M

PËR DHËNJEN E PËLQIMIT NË KËRKESËN, 01Nr.07/1572
TË HAJRI XHELILIT, FIRMA NPSH"SHPEJTIMI" - SHTIME

I


Kuvendi Komunal-Shtime, në mbledhjen e tetë të rregullt për vitin 2012, të mbajtur më: 6.9.2012, me shumicën e votave aprovoi kërkesën 01Nr.07/1572, datë: 7.8.2012 të z.Hajri Xhelilit nga Shtimja, përfaqësues i firmës NPSH. ("Shpejtimi") dhe i jep pëlqim për shfrytëzimin dhe përpunimin e Gurit natyror, në gjithësejt 3 (tre) hektarë sipërfaqe, në ngastrën kadastrale Nr.800-0 në vendin e quajtur "Lugu i Shtogut" Z.K.-Belinc, Pasuri Shoqërore e Ekonomisë Pyjore.

II

Pëlqimi palës i lëshohet për rregullimin e dokumentacionit për leje të punës, që duhet ta sigurojë nga Ministria për Planifikim Hapësinor, përkatësisht nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. Pala është e obliguar që brenda 6 (gjashtë) muajve të fillojë aktivitetet për përpunimin e gurit, në këtë lokacion në të kundërtën ky vendim anulohet.

III


Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesi Kuvendit
Kujtim Xhelili



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr. 06/1695 Datë: 23.8.2012



Npi – 01/191, Datë: 6.9.2012

Kuvendi Komunal-Shtime, në mbledhjen e tetë, të rregullt për vitin 2012, të mbajtur më: 6.9.2012, shqyrtoi edhe Propozimin e Kryetarit të Komunës që në kuadër të kërkesës për ndarjen e trojeve për Invalidët e Luftës të shqyrtohet edhe mundësia që edhe familjes të dëshmorit Ali Tafa nga Carraleva ti ndahet një truall, sepse në grupin e trojeve që i janë ndarë dëshmorëve ky nuk ka qenë i përfshirë.

Bazuar në nenin 12.d, 14.1 dhe 17.c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, pastaj duke marrë parasysh edhe rekomandimet e Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, si dhe rekomandimet e Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi Komunal-Shtime mori këtë:

V E N D I M

**PËR NDARJEN E NJË TRUALLI PËR FAMILJEN E DËSHMORIT
ALI Tafa nga FSHATI CARRALEVË**

I


Kuvendi Komunal – Shtime, në mbledhjen e tetë, të rregullt, për vitin 2012, të mbajtur më datën: 6.9.2012, me shumicën e votave aprovoi Propozimin e Kryetarit që ti ndahet 1 (një) truall, prej 4 (katër) ari sipërfaqe, familjes të Dëshmorit Ali Tafa nga Carraleva, në vendin e quajtur Çestë-Shtime, në ngastrën kadastrale Nr.2148/1, Z.K-Shtime, me arsyetimin se kjo familje, nuk është përfshirë në grupin e parë kur janë ndarë troje për familjarët e dëshmorëve.

II

Kuvendi Komunal, i Rekomandon Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi që sipërfaqja të definohet, në përputhje me këtë Vendim, duke respektuar, Planin Urbanistik.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, si dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesi i Kuvendit
Kujtim Xhelili



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr. 06/1695 Datë: 23.8.2012



Npi – 01/190, Datë: 6.9.2012

Kuvendi Komunal-Shtime, në mbledhjen e tetë, të rregullt për vitin 2012, të mbajtur më: 6.9.2012, shqyrtoi kërkesën, 01Nr.07/1165, datë:20.6.2012, të z.Ibrahim Bunjaku, Kryetar i Shoqatës së Invalidëve të Luftës dega në Shtime, i cili ka kërkuar në emër të Shoqatës nga Kuvendi Komunal-Shtime, që t'i ndajë 10 Troje për Invalidët e Luftës. Duke analizuar kërkesën e palës, mbi bazën e nenit 12.d, 14.1 dhe 17.c të Ligjit për Veteqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, pastaj duke marrë parasysh edhe rekomandimet e Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, si dhe rekomandimet e Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi Komunal-Shtime mori këtë:

V E N D I M

**PËR NDARJEN E 10 TROJEVE
PËR INVALIDËT E LUFTËS SË UÇK-së DEGA NË SHTIME**

X

I

Kuvendi Komunal – Shtime, në mbledhjen e tetë, të rregullt, për vitin 2012, të mbajtur më datën: 6.9.2012, me shumicën e votave aprovoi, Kërkesën 01Nr.07/1165, datë:20.6.2012, të z.Ibrahim Bunjakut, në emër të Shoqatës së Invalidëve të Luftës dega në Shtime, kështu që Kuvendi Komunal i ndanë 10 troje, me nga 4 (katër) ari sipërfaqe në vendin e quajtur Çestë-Shtime, në ngastrën kadastrale Nr.2148/1, Z.K-Shtime.

II

SHIL- Dega në Shtime, me këtë vendim merr obligim që të ndajë trojet invalidëve të luftës, mbi bazën e këtij vendimi dhe kriterëve që i përcakton shoqata, e të cilat invalidët e luftës i plotësojnë më së miri.

III

Kuvendi Komunal, i Rekomandon Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi që sipërfaqja të definohet, në përputhje me këtë Vendim, dhe vendimin e shoqatës duke respektuar, Planin Urbanistik.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, si dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesi i Kuvendit
Kujtim Xhelili